Dr. Lab
15.02.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**

LAB
20.02.2023

Nr 2477/1 prot. Tiranë, më 14.02.2023

# UDHËZIM

**Nr. 01, datë 14.02.2023**

**PËR**

**"PROÇEDURAT E MOSTRIMIT, TRANSPORTIMIT, PRANIMIT, RUAJTJES SË MOSTRAVE, ADMINISTRIMIT TË REZULTATEVE LABORATORIKE DHE HARTIMIT TË "CERTIFIKATAVE TË VERIFIKIMIT TË LLOJIT TË MALLIT DHE KLASIFIKIMIT TARIFOR"**

Legjendë:

Me qëllim permirësimim dhe unifikimin e proçedurave laboratorike, bashkërendimin e veprimeve ndërmjet Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës, Drejtorisë së Laboratorit Doganor me Degët Doganore dhe me strukturat e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave,

Në zbatim të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, VKM nr.651, datë 10.11.2017 "Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit nr.102/2014, date 31.07.2014 "Kodi Doganor i RSH", Ligjit 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, "VKM 612, dt. 05.09.2012, "Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe pikën 1(b)(i) dhe 2(c)(ii), të Pjesës VIII/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.921, datë 29.12.2014, "Për personelin e administratës doganore", të ndryshuar

## UDHËZOJ:

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1 **"Manual Mostrimi"** - është dokumenti bashkëlidhur, që është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi, përmes të cilit rregullohen parimet e përgjithshme apo proçedurat specifike, lidhur me marrjen, mbajtjen, transportimin, trajtimin, etj. e mostrave.

2 **"Mostër"** - është sasia e nevojshme e një malli të caktuar (në varësi të llojit), e përftuar ose e marrë nga një parti malli, e përftuar nga zgjedhja ose ndarja (në njësi individuale) dhe e pranuar për të përfaqësuar mallin në tërësi.

3 **"Mostrim" ("proçesi i marrjes së mostrës")** - është bashkësia e veprimeve të planifikuara, duke respektuar të gjitha teknikat dhe parametrat sasiore të nevojshme, sipas standardeve në fuqi

(në varësi të llojit të mallit), për të marrë, homogjenizuar, reduktuar, paketuar, identifikuar, plumbosur, etiketuar, transportuar me mjete të përshtatshme dhe dorëzuar në mënyrë të dokumentuar mostrat për analizim.

4 **"Paisje marrje mostre"** - është instrument/makineri, mjet i përshtatshëm, i specifikuar nga standartet për marrje, homogjenizim dhe paketim të mostrës dhe i miratuar nga palet e interesuara, i përbërë prej materiali të qëndrueshëm dhe që nuk ndikon në karakteristikat e mostrës.

5 **"Mostër mesatare"** - është përzierje homogjene e mostrave të marra në pika të ndryshme nëpërmjet reduktimit të përmasave të përzierjes së përftuar në mënyra specifike.

6 **"Mostër për ruajtje** (mostër rezervë, dublikatë)" - është mostra e marrë në prani të të gjitha palëve të interesuara, e destinuar për ruajtje specifike, në raste të ekspertizës ose çertifikimit të produkteve, me qëllim për ta përdorur për testime eventuale kur lindin dyshime, mosmarrëveshje ose probleme te mëvonshme.

7 **"Proçesverbali i marrjes se mostres"** - është/janë informacioni/et i detyrueshëm dhe jo i detyrueshem nga standardet përkatëse, të cilat dokumentohen nga mostruesi, gjatë proçesit të marrjes së mostrës dhe nënshkruhen nga palët e interesuara, me qëllim demonstrimin e proçesit dhe transferimin e të dhënave të duhura laboratorit për testim.

8 **"Mostrues"** - është personi/personat e autorizuar nga organe kompetente per të kryer veprime sipas proçedurave standarte, gjatë proçesit të marrjes së mostrave specifike. Në varësi të llojit të mallit, mostrues mund të jenë doganierë të kontrollit fizik, si dhe punonjës të tjerë të Administratës Doganore, të trajnuar nga Drejtoria e Laboratorit Doganor për këtë qëllim. Në rastin e marrëveshjeve, të nënshkruara ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me ente, organizma apo institucione të specializuara, mostrues mund të jenë dhe persona të autorizuar nga një marrëveshje e tillë.
Në asnjë rast nuk lejohet të merren mostra nga të tretët, për llogari të Doganës, pa marrëveshje dypalëshe të DPD-së me institucionet në fjalë.

9 **"Magazinieri"** – është personi i autorizuar në Drejtorinë e Laboratorit që bën verifikimin, pranimin, regjistrimin në sistemin LIMS, magazinimin e mostrës në Laborator deri në tërheqjen e saj për analizim nga Sektori i Analizave .

10**"Metoda dhe teknika e analizimit"** - janë metodat dhe teknikat e miratuara nga Standardet Shqiptare, Organizata Ndërkombëtare e Standardeve (ISO) si dhe metodat analitike të zhvilluara nga vetë laboratori.

11 **"Rezultate testimi"**- janë të dhëna që janë përftuar nga zbatimi i metodave/proçedurave të testimit dhe mund të jenë cilësore (p.sh. po/jo) dhe sasiore (vlera te matura), të gjeneruara nga observimet personale ose outputet e instrumentave matës.

12 **"Raport testimi"** është dokumenti teknik që raporton rezultatet e një apo disa analizave të kryera sipas një specifikimi teknik (standard apo metodë) duke iu referuar vetëm mostrës së testuar.

13 **"Konkludim"** - është nxjerrja e një konkluzioni të caktuar, i cili bazohet në rezultatet e analizës, Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, bazuar në Sistemin e Harmonizuar, Notave Shpjeguese të saj, dokumentave shoqëruese të cilësisë, Skedave Teknike, Skedave të Sigurisë (Safety Data Sheet) etj.

etj.

**14 "Çertifikata e Verifikimit të Llojit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor"** - është dokumenti i nxjerrë nga Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, ku pasqyrohen emërtimi i saktë i mallit si dhe kodi tarifor tij, mbështetur në Nomenklaturën e Kombinuar të Mallrave, rezultatet e analizave (testimeve) të kryera, të cilat janë të domosdoshme për klasifikimin tarifor korrekt të mallit.

**15 "Fletë analize"** – është dokumenti i nxjerrë nga Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës, në të cilin janë të pasqyruara të gjitha të dhënat analitike të kryera mbi mostrën, që nuk përmban të dhëna mbi emërtimin e saktë të mallit dhe klasifikimi i tij tarifor.

**16 "Asgjësim"** - është proçesi i eliminimit që nuk parashikon përpunim tjetër të mbetjes/mostrës.

**DLD** - Drejtoria e Laboratorit Doganor

**DTO**- Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës

**DPD** - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

**S.M.A** - Sektori i Standardeve, Metodikave dhe Administrimit

**S.T.K.T** - Sektori i Tarifës dhe Klasifikimit Tarifor pranë Dr. së Tarifës dhe Origjinës

**S.A** - Sektori i Analizave

**SMC** - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

**Praktika** - Tërësia e dokumentave shoqërues të "Kërkesës për Verifikim të llojit të mallit dhe Klasifikit Tarifor të mostrës".

**Sistemi LIMS**- Sistemi i menaxhimit të informacionit laboratorik

## 2. ARTIKUJT QË ANALIZOHEN DHE DELEGOHEN NGA DREJTORIA E LABORATORIT DOGANOR

**2.1** Artikujt që analizohen aktualisht në Drejtorinë e Laboratorit Doganor, janë përfshirë në *Aneksin 1 "Lista e artikujve që analizohen aktualisht në Drejtorinë e Laboratorit Doganor"* bashkëlidhur, pjesë e këtij Udhëzimi. Ky Aneks mund të ndryshojë, në varësi të kapaciteteve që ka Laboratori Doganor. Ndryshimet e *Aneksit 1*, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm, i bëhen me dije në vijimësi strukturave doganore me shkresë zyrtare dhe në rrugë elektronike.

**2.2** Në raste të kërkesave, për të cilat Laboratori Doganor nuk ka kapacitete teknike dhe profesionale, mostrat delegohen në Laboratorë të Akredituar, bazuar në marrëveshje të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dërgon pranë Degëve Doganore, Drejtorisë së Origjinës dhe Tarifës si dhe Drejtorisë së Laboratorit Doganor, çdo marrëveshje të re, që nënshkruhet ndërmjet DPD dhe Laboratorëve të tjerë. Së bashku me këtë njoftim dërgohet edhe kopja e listës së produkteve që

mund të analizohen në këta Laboratorë.

**2.3**. Në rast se mostra delegohet për analizë në një laborator tjetër, Drejtoria e Laboratorit Doganor i bën me dije Degës Doganore dhe Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës për delegimin e saj, si nëpërmjet sistemit LIMS ashtu dhe në rrugë shkresore. Afatet kohore gjatë të cilave mostra analizohet në laboratorë të jashtëm ndryshojnë në varësi të kushteve të përcaktuar në secilën marrëveshje.

Shkresën për delegimin e mostrave në laboratorë të jashtëm dhe delegimin fizik të mostrës e ndjek Drejtoria e Laboratorit Doganor (duke qënë se mostrat dorëzohen në këtë drejtori).

Për çdo rast pas mbërritjes së faturës së lëshuar nga laboratori i tretë, kopja elektronike e tyre i vihet në dispozicion STKT me email, nga ana e SMA, për të konfirmuar nëse analizat e kërkuara prej tyre janë të përfshira qartësisht në këtë dokument.

Në të njëjtën mënyrë veprohet dhe me Raportin e Testimit të lëshuar nga laboratori i jashtëm, ky dokument kalohet me email në STKT, me qëllim konfimimin nga ana e tyre nëse rezultatet e analizave të kryera janë të qarta dhe të mjaftueshme për konkludimin e klasifikimit tarifor.

Pas konfirmimit nga DTO, me Raport Testimin e laboratorit të jashtem veprohet njësoj si me Raport Testimet e lëshuara nga Drejtoria e Laboratorit Doganor. Ky dokument i shoqëruar nga një shkresë përcjellëse, i kalon për kompetencë dhe procedim të mëtejshëm DTO/STKT, si në Sistemin LIMS ashtu dhe në rrugë shkresore.

Fatura e lëshuar nga laboratori i tretë për analizat e kryera pranë tyre, pasi protokollohet në DPD, kalon për ndjekje dhe ngarkim në sistemin LIMS, nga DLD/SMA. Mbështetur mbi këtë faturë, DLD/SMA njofton Degën Doganore përkatëse për detyrimin që duhet të shlyejë subjekti për analizat e deleguara.

"*Certifikata e verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor*", nuk lëshohet pa u konfimuar më parë shlyerja e detyrimit nga ana e subjektit për analizat e deleguara, për të mos rezikuar kështu zbatimin e marrëveshjeve të lidhura nga DPD me laboratorë të jashtëm.

**2.4** Në rast mosanalizimi të mostrës si në Drejtorinë e Laboratorit Doganor ashtu dhe në laboratorët e jashtëm me të cilët bashkëpunon DPD, Drejtoria e Laboratorit Doganor njofton Degën Doganore dhe Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës. Njoftimi bëhet si në rrugë shkresore ashtu dhe nëpërmjet sistemit LIMS. Pas marrjes së këtij njoftimi, punonjësi i degës doganore që paraqitet në Drejtorinë e Laboratorit për dorëzim të mostrave ose një punonjës tjetër i pajisur me autorizim nga dega doganore, do të bëjë tërheqjen e kësaj motre nga ambjentet e DLD. Këtë mostër dega ia kthen subjektit ose përfaqësuesit të tij, shoqëruar me proçesverbal.

## 3. MARRJA E MOSTRËS, DORËZIMI DHE PRANIMI NË DREJTORINË E LABORATORIT DOGANOR

**3.1** Mostra e marrë sipas udhëzimeve të dhëna në "Manualin e Mostrimit", ndahet në tre mostra njëlloj të vlefshme, identike. Të treja mostrat identike, pasi etiketohen, sipas modelit të "*Etiketës së mostrimit*" të paraqitur në *Aneksin 3*, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, plumbosen dhe vulosen nga mostruesi.

Mostra duhet të përfaqësojë një lloj të vetëm malli. Në asnjë rast nuk duhet që me të njëjtën plumbçe të plumboset më shumë se një mostër (mall).
-Një mostër dërgohet në Drejtorinë e Laboratorit Doganor për analizim.

-Një mostër ruhet si mostër dublikatë në Degën Doganore përkatëse dhe përdoret në rast aprovimi të kërkesës për rianalizim;
- Një mostër i jepet përfaqësuesit të subjektit e shoqëruar me - *"Procesverbalin e marrjes së mostrës" Aneksi 4* . Kjo mostër ruhet nga subjekti për qëllime të vetat dhe nuk përdoret në rast rianalizimi nga Autoritet Doganore.

Doganieri bën rregjistrimin e tyre në sistemin LIMS.

Në mënyrë automatike gjatë rregjistrimit në sistemin LIMS, të treja këtyre mostrave i vendoset i njëjti Numër Serial Identifikimit. Ky numër do të shërbejë për identifikimin e mostrës si në rregjistrin e magazinës së Degës Doganore ashtu dhe në *"Kërkesën për klasifikimin tarifor të mostrës"* (*Aneksi 5*).

E drejta e hyrjes në sistemin LIMS, bëhet nëpërmjet llogarisë së përdoruesit të identifikuar me "emër përdoruesi" dhe "fjalëkalim", në përputhje me standardet e sigurisë së AKSHI-t të aplikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Specialistët e Sektorit "Zgjidhje support (helpdesk)", krijojnë/ modifikojnë përdorues në sistemin LIMS, referuar e-mailit të paraqitur nga përgjegjësi/eprori direkt i punonjësit, i cili kërkon krijimin e përdoruesit. Përdoruesit e sistemit LIMS kur hasin vështirësi me log-imin në sistem, duhet të dërgojnë e-mail nga adresa e tyre zyrtare emër.mbiemër@dogana.gov.al në adresën helpdesk.dpd@dogana.gov.al. Dega doganore, duhet të informojë menjëherë, Drejtorinë e Laboratorit Doganor dhe Sektorin e Zgjidhje Suport (Helpdesk), të cilët njoftojnë Drejtorinë TIK të AKSHI-t pranë Doganave, për çdo rast të mosfunksionimit të sistemit LIMS. Punonjësit doganore, janë të detyruar të njoftojnë për të gjitha problemet e identifikuara që lidhen me funksionimin dhe aplikimin.

Nëpërmjet sistemit LIMS, punonjësi në Degën Doganore plotëson:

-*"Kërkesën për analizimin dhe klasifikimin tarifor të mostrës" Aneksi 5,*

-*"Procesverbalin e marrjes së mostrës" Aneksi 4,*

-*"Etiketën e mostrimit" Aneksin 3,*

-*"Formularin e marrjes së mostrës" Aneksi 6.*

Me përjashtim të *"Procesverbalit të marrjes së mostrës" Aneksi 4*, përmbajtja e të cilit duhet të jetë e lexueshme vetëm nga dega doganore që bën kërkesën për klasifikim tarifor, dokumentat e tjera të lartpërmendura janë të lexueshëm në sistemin LIMS nga ana e Drejtorisë së Laboratorit Doganor dhe Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës.

Informacioni i plotësuar në sistemin LIMS, duhet të jetë i njëjtë me atë të paraqitur në kopjen fizike letër (praktikën e dorëzuar në Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës).

Një kopje e tyre e printuar dhe e protokolluar në degën doganore, dërgohet pranë DPD, për tu protokolluar dhe për t'i kaluar më tej zyrtarisht Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës për ndjekje të mëtejshme.

**3.2** Mostra dhe dokumentacioni i saj dërgohen për verifikim në DLD nga personi që ka kryer mostrimin ose një punonjës i autorizuar nga dega doganore.

Në asnjë rast nuk duhet dorëzuar praktika për rregjistrim në zyrën e Protokoll Arshivës në DPD, pa marrë më parë konfirmimin për rregullsinë e mostrës dhe dokumentacionit shoqërues të saj në zyrën e pranimit të mostrave në Drejtorinë e Laboratorit.

Mostra pranohet si e rregullt në Drejtorinë Laboratorit Doganor dhe kalon për analizim vetëm kur plotësohen kriteret e mëposhtme:

1. Është e etiketuar sipas Aneksit 3 (bashkëlidhur) e cila është e plotësuar saktë në të gjitha zërat e saj dhe përmban informacion që përputhet me dokumentacionin shoqërues të mostrës si dhe numrin e plumbçes përkatëse.
2. Plumbosja e mostrës është kryer konform rregullave të përcaktuara në Manualin e mostrimit bashkëlidhur me këtë udhëzim, duke siguruar pacënueshmërinë e mostrës.

3.3 Dokumentacioni shoqërues i mostrës i cili printohet në Degën Doganore nga sistemi LIMS, pranohet si i rregullt nga Magazinieri, nëse përmban:

1. *"Kërkesën për Analizim dhe Klasifikim Tarifor"* të mostrës sipas *Aneksit 5* bashkëlidhur, pjesë e këtij udhëzimi;
2. Formularin e marrjes së mostrës sipas modelit të paraqitur në *Aneksin 6* bashkëlidhur, pjesë e këtij udhëzimi;
3. Çertifikatën e cilësisë së mallit ose fotokopje të saj, të lëshuar nga vendi eksportues, prodhuesi, ose laborator testues i specializuar. Çertifikata, duhet të shoqërojë amallrat si: aditivë, solventë, produkte energjitike, lëndë e parë, nënproduktet e qumështit, ushqimet për kafshë, të gjithë mallrat e tjerë të shoqëruar nga ky dokument si dhe mallrat e përfshira në akcizë. Për mostrat e marra nga Departamenti Akcizës, ky dokument nuk është i detyrueshëm. Në këtë çertifikatë duhet të jenë të fshira/të padukshme të dhënat që identifikojnë subjektin tregtar;
4. Skedë Teknike, Skedë Sigurie (Safety Data Sheet) ose etiketë ambalazhi për mallrat e përfshirë në *Aneksin 2*, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Ky dokument është kusht i domosdoshëm për të mundësuar analizën e këtyre artikujve në DLD apo në laboratorët e tjerë më të cilët DPD ka të lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Në mungesë të këtij dokumenti, vetë sistemi LIMS, nuk lejon mbylljen e rregjistrimit të praktikës në degën doganore.
   Kërkohet që SDSH ose Skeda Teknike ti përkasë mallit të mostruar, pasi dokumenti duhet të sigurojë informacion të vlefshëm vetëm për atë mostër. Në rast të kundërt mostra nuk do të analizohet por do të kthehet mbrapsht e paanalizuar.
5. Dokumentacioni i fotokopjuar duhet të jetë i njehsuar me origjinalin nga Struktura Doganore, që ka kërkuar klasifikimin tarifor të mostrës.

Magazinieri në DLD, kryen kontrollin e rregullsisë së mostrës dhe dokumentacionit shoqërues të saj në sistemin LIMS. Në rast se nuk hasen parregullsi gjatë kontrollit të tyre, mostra pranohet si e rregullt në DLD dhe dokumentacioni shoqërues i tyre kalon për protokollim në DPD.

Në rastet kur gjatë këtij kontrolli hasen parregullsi, Drejtoria e Laboratorit Doganor njofton degën doganore dhe Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës nëpërmjet sistemit LIMS si dhe në rrugë shkresore se mostra dhe dokumentacioni shoqërues i saj nuk pranohen për shkak të parregullsive të paraqitura në *"Kërkesën për rregullim të mostrës"*. Në këtë rast praktika nuk dërgohet për protokollim në DPD.

Nëse zgjidhen jokonformitet e hasura, praktika e re duhet të lidhet në sistemin LIMS, me atë të mëparshmen për të pasur kështu dhe në sistem një lidhje mes tyre.

Ne rast të mos zgjidhjes së tyre, Dega doganore duhet te mbyllë këtë praktikë në sistem dhe të informojë Drejtorinë e Laboratorit dhe Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës, për arsyet e mos zgjidhjes së jokonformiteteve të hasura.

**3.4**. Strukturat që kanë të drejtë, mbi bazën e informacioneve dhe/ose rreziqeve të mundshme të kërkojnë analizim të mallrave në Laboratorin Doganor janë:

a. Degët Doganore;
b. Departamenti Operativ-Hetimor;
c. Departamenti Teknik
d. Departamenti i Akcizes
e. Organe shtetërore të tjera si p.sh. Prokuroria, Policia e shtetit, Drejtoria Tatimeve, etj.,

Strukturat e listuara në pikën e),duhet të dërgojnë më parë kërkesën e tyre pranë DPD dhe pasi të marrin aprovimin nga Drejtori i DPD, i kalojnë Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës për të ndjekur të njëjtën rrugë që ndjekin *"Kërkesat për analizë dhe klasifikim tarifor"*të dërguara nga degët doganore.

**3.5** Metodika e marrjes së mostrave, sasia e nevojshme për analizë, ambalazhimi i mostrave, dhe kushtet e ruajtjes, transportit dhe magazinimit të tyre janë të përcaktuara në Skedat e mostrimit në "Manualin e Mostrimit", pjesë e këtij Udhëzimi.
Në këto skeda, është përcaktuar sasia minimale e mostrës sipas kategorizimeve të mallrave (në mallrat të ngurtë, artikuj ushqimorë të lëngët, me viskozitet të lartë apo të ulët, etj), që do të thote së mostra nuk duhet të jetë në sasi më të vogël se ajo e kërkuar në skedën e mostrimit. Në shumicën e rasteve, sasia e mjaftueshme e mostrës për të kryer të gjitha analizat e kërkuara është rreth 1 L .

## 4. DËRGIMI I MOSTRAVE NGA DEGËT DOGANORE

**4.1** Mostrat e marra sipas udhëzimeve në "Manualin e Mostrimit", duhet të ruhen dhe transportohen duke respektuar të gjitha kërkesat për ruajtjen dhe transportimin e tyre në kushte optimale.

**4.2** Mostra, duhet të dorëzohen në Laboratorin Doganor jo më vonë se 5 ditë pune nga dita e mostrimit, por ky afat mund të jetë më i shkurtër në rastin e mallrave që prishen shpejt, si dhe në varësi të kushteve për ruajtjen e mostrës në Degë Doganore (për mallra që prishen shpejt apo jo).

**4.3** Nëse kalon afati i përmendur në pikën 4.2, struktura doganore (Kryetari i Degës Doganore), që ka kërkuar klasifikimin tarifor të mostrës, duhet t'i paraqesë arsyet e vonesës Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës dhe Drejtorisë si dhe Drejtorisë së Laboratorit Doganor nëpërmjet sistemit LIMS, si edhe me shkresë zyrtare. Drejtoria e Laboratorit Doganor, pas verifikimit të mostrës, në varësi të gjendjes së saj, përcakton nëse ajo mund të pranohet ose jo për analizim.

**4.4** Mostruesi është personi përgjegjës për ndjekjen e procedurës së marrjes së mostrës, plotësimin e të gjitha të dhënave që lidhen me të në sistemin LIMS. Ruajtja, transportimi dhe dorëzimi i mostrës në Laboratorin Doganor, kryhet nga mostruesi apo nga persona të autorizuar nga struktura doganore, që ka kërkuar analizimin e mostrës.

**4.5** Në rast se ka marrëveshje të nënshkruara, për transportimin dhe dorëzimin e mostrave nga operatorë jashtë sistemit doganor, atëherë këto procese kryhen sipas përcaktimeve të bëra në to.

**4.6** Dërgimi i mostrave, kur gjykohet e arsyeshme, në varësi të rrethanave, mund të bëhet sipas mënyrave të tjera të dërgimit, të përcaktuara në Manualin e Mostrimit.

## 5. KËRKESË PËR ANALIZIM TË MOSTRËS NGA DREJTORIA E TARIFËS DHE ORIGJINËS (IDT)

**5.1** Marrja e mostrës për analizim, për qëllime të ITD kryhet:

- në import në bashkëpunim me degën doganore
- vetëdeklarim (në rast kur është e pamundur marrja e mostrës në import)

Mostra e ardhur nga Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës me qëllim analizimin nga ana e Laboratorit, duhet të shoqërohet me një "*Kërkesë për analizë*" ku të përfshijë elementë identifikues si emërtimi, natyra e mallit, ambalazhi, etj., si dhe dokumentin shoqërues si *Skedë teknike, Certifikatë cilësie, MSDS apo Etiketën e mallit*, që të japin informacion mbi natyrën e mallit dhe përmbajtjen e tij si dhe Formularin e marrjes së mostrës.
"*Formulari i marrjes së mostrës*", plotësohet në të gjithë zërat nga punonjësi i Drejtorisë së Tarifës dhe Origjinës, dhe në momentin që plotësohet dhe "Kërkesa për analizë", ky informacion shfaqet në Sistemin LIMS për Drejtorinë e Laboratorit.

Mostra në laborator vjen e paplumbosur, kontrollohet në grup pune i cili përbëhet nga Dorezuesi i mostrës, magazineri dhe një specialist i Sektorit të Analizave (sipas natyrës së mostrës), plumboset dhe plotësohet procesverbali i plumbosjes së mostrës. Përpunuesi i informacionit bën regjistrimin e numrit të Protokollit të praktikës dhe të numrit të plumbces në sistemin LIMS, në rubrikën përkatëse.

Në Laborator procedura për analizimin dhe konkludimin e mostrës ndiqet e njëjtë si për mostrat që vijnë për analizim nga Degët Doganore dhe analizohen me prioritet (shih piken 7.3).

Në rastet kur mostra nuk mund të analizohet, plotësohet në sistemin LIMS, Moduli përkatës dhe kthehet mbrapsht me arsyet për pamundësinë e kryerjes së analizës.

Në rastet kur mostra e administruar me vetëdeklarim, nuk plotëson kushtet për vlerësim të mëtejshëm, DTO kërkon të marri mostra në import në bashkëpunim me degën doganore mbikqyrëse sipas procedurave të përcaktuara në "Manualin e Mostrimit". Marrja e mostrave në këtë rast mund të kryhet edhe në prezencë të përfaqësuesve të DTO.

**5.2** Verifikimi

Për qëllime të identifikimit të problematikave dhe zbatueshmërisë në mënyrë korrekte të ITD-së, brenda periudhës së vlefshmërisë (3 vjet), DTO mund të kryejë kontrolle periodike tek operatori përfitues i autorizimit si dhe të marri mostra të mallit për të cilin është aplikuar vendimi i favorshëm IDT.

## 6. "KËRKESË PËR ANALIZIM TË MOSTRËS" NGA ORGANE TË TJERA SHTETËRORE, PROKURORIA, POLICIA E SHTETIT, DREJTORIA E TATIMEVE, ETJ.

Mostra duhet të shoqërohet nga një "*Kërkesë për analizë*" nga organi kërkues. Kjo shkresë duhet protokolluar në DPD.
Pranimi i këtyre mostrave bëhet në grup pune i cili përbëhet nga dorëzuesi, magazinieri dhe një specialist i Sektorit të Analizave (sipas natyres së mostrës). Në çdo rast kryhen kontrollet,

verifikimet dhe plumbosja e mostrës (në rastet kur ajo nuk ka vula apo plumbçe sigurie të vendosura nga dorëzuesi) duke mbajtur regjistrimet në procesverbal, i cili firmoset nga të tre personat prezentë. Mostra regjistrohet nga magazinieri në sistemin LIMS në rubrikën "Të tjera".

Në Laborator procedura për analizimin dhe konkludimin e mostrës ndiqet e njësoj si për mostrat që vijnë për analizim nga Degët Doganore dhe analizohen me prioritet (shih piken 7.3).

## 7. ANALIZIMI I MOSTRAVE

**7.1** "*Kërkesa për analizimin dhe klasifikimin tarifor të mostrës*" dhe dokumentacioni shoqërues i mostrës dorëzohen në DPD për tu rregjistruar në zyrën e protokollit dhe pasi siglohet nga Dr. Departamentit Teknik kalon për procedim të më tejshëm në DTO.

Personi përgjegjës në DTO, bën rregjistrimin e tyre në sistemin LIMS. Pas rregjistrimit, praktikat i kalojnë në sistem Drejtorit të DTO, i cili ia kalon ato Përgjegjësit të STKT duke ndjekur rradhën e protokollit.

Përgjegjësi i Sektorit të Tarifës dhe Klasifikimit Tarifor, nëpërmjet sistemit LIMS përcakton specalistin që do të ndjëkë praktikën. Ky i fundit plotëson "*Kërkesën për analizë*" e cila i kalon DLD në sistemin LIMS si dhe i dërgohet kësaj drejtorie me një shkresë përcjellëse të protokolluar. Afati maksimal brenda të cilit kryhet klasifikimi tarifor i mostrës është 10 ditë pune. Në këtë interval përfshihen vetëm koha për hartimin e "Kërkesës për analizë" drejtuar DLD si dhe koha për konkludimin e klasifikimit tarifor dhe lëshimit të "Certifikates se Klasifikimit Tarifor".

Analizimi i mostrës në DLD duhet të kryhet brenda afatit 10 ditë pune, duke filluar nga data që mostra tërhiqet nga magazina dhe kalon për analizë. Këto afate kohore nuk aplikohen në rastet e delegimit të mostrave në laboratorë të jashtëm, pasi kohëzgjatja e analizës së tyre është e përcaktuar në marrëveshjet e sicilit laborator të jashtëm me DLD.

Kur afatet e mësipërme tejkalohen, duhen pasqyruar në sistem arsyet që çuan në tejkalimin e tyre.

**7.2** Për rastet kur mostrat delegohen në laboratorë të jashtëm, afati i kryerjes së analizave varion nga proçedura e delegimit. Dega Doganore njoftohet nëpërmjet sistemit LIMS dhe në rrugë shkresore për mostrat që do të delegohen për analizë në një laborator të jashtëm, si dhe për detyrimet që duhet të shlyejë subjekti i inspektuar për kryerjen e këtyre analizave. Dega doganore është përgjegjëse për njoftimin e subjektit për shlyerjen e detyrimit financiar për analizat e deleguara si dhe ngarkimin e faturës së likujduar në sistem. Vonesat në shlyerjen e ketyre detyrimeve, mbajnë të bllokuara në sistem Raport Testimet e lëshuara nga laboratorët e jashtëm, duke u bërë kështu arsye vonese në hartimin dhe lëshimin e "*Certifikatave të verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor*". Dega doganore duhet të njoftojë Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në rrugë shkresore si dhe Drejtorinë e Laboratorit Doganor dhe Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës nëpërmjet sistemit LIMS për shlyerjen e këtij detyrimi, duke ngarkuar faturën e paguar.

DTO lëshon "*Certifikatën e verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor të tij*" vetëm pasi fatura e shlyerjes së detyrimit financiar nga ana e subjektit ngarkohet nga doganieri i kontrollit fizik në sistemin LIMS dhe është e dukshme për Drejtorinë e Laboratorit.

**7.3** Në raste specifike, për nevoja urgjente pune, kur gjykohet e arsyeshme, analizimi i mostrave mund të kryhet pa ndjekur rradhën e protokollit, me autorizimin e Drejtorit të DTO, i cili evidenton këtë urgjencë nëpërmjet sistemit LIMS:

Ndër rastet specifike përmendim:

- Mostrat të cilat nuk vendosen në qarkullim të lirë pa u lëshuar më parë "Certifikata e verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor të tij" si në rastin e gazoileve të ngjyrosura.
Mostrat të cilat në pritje për tu analizuar pësojnë ndryshime në karakteristikat fiziko-kimike të tyre si psh: pijet alkolike rifuxho,etj"
-Mostrat të cilat janë të shoqëruara nga një kërkesë nga kryetari i Degës Doganore, në të cilën argumentohen arsyet për të cilat analizmi i mostrës duhet të trajtohet me përparësi .

**7.4** Në rastet e analizimit të mallrave të përfshira në vendime eksiztuese si p.sh mallrat e akcizës, VKM nr. 38 datë 21.01.2016 për Biokarburantet, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të këshillit të ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit "për akcizat"", të ndryshuar") dhe Vendimeve të reja që mund të dalin, mostrat përfaqësuese të këtyre mallrave, do të analizohen pa ndjekur radhën e protokollit.

**7.5** Për një shfrytëzim sa më efikas të aparaturave dhe analizimin në kohë sa më të shkurtër të mostrave, specialisti i DLD, mund të tërheqë kërkesat për analizë për grup mallra me natyrë të njëjtë, të ardhura brenda nje periudhë të afërt kohore.

## 8. HARTIMI DHE ADMINISTRIMI I RAPORTIT TË TESTIMIT

8.1 "*Raporti i Testimit*" gjenerohet nga sistemi LIMS sipas formatit të Aneksit bashkëlidhur, pjesë e këtij udhëzimi, bëhet pjesë e praktikës doganore dhe përmban të dhëna të përgjithshme të mostrës së analizuar (kërkuesin, mallin, kodin tarifor të deklaruar, etj.) si dhe rezultatet e analizave të marra nga analizimi i mostrës në Laborator.

8.2 "*Raporti i Testimit*" që përmban qoftë edhe vetëm një nga treguesit e akredituar do të jetë me logon e Akreditimit.

8.3 "*Raporti i Testimit*" përgatitet në 3(tre) kopje origjinale të cilat shoqëruar me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga Drejtori i Laboratorit, dorëzohen në zyrën e protokollit në DPD dhe shpërndahen si më poshtë:
- një kopje e tij e firmosur nga specialisti që ka kryer analizën dhe Përgjegjësi i Sektorit të Analizave, i bashkëlidhet praktikës e cila arshivohet në arshivën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- dy kopje pa firmat e specialistit dhe të Përgjegjësit të Sektorit të Analizave i kalohet Drejtorisë se Tarifës dhe Origjinës bashkëlidhen me kopjet e "*Çertifikatës së Verifikimit të Llojit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor* ".

8.4 "*Raporti i Testimit*" është i vlefshëm në origjinal dhe vetëm për mostrën e analizuar. Ai firmoset nga specialisti dhe Përgjegjësi i Sektorit të Analizave vetëm në kopjen që arshivohet në DPD dhe i bashkëlidhet Certifikatës së Verifikimit të Llojit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor/ Fletë Analizës.

## 9. HARTIMI DHE ADMINISTRIMI I CERTIFIKATËS SË VERIFIKIMIT TË LLOJIT TË MALLIT DHE KLASIFIKIMIT TARIFOR DHE I FLETË ANALIZËS

**9.1** "*Çertifikata e Verifikimit të Llojit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor* " sipas formatit të *Aneksit 8* bashkëlidhur, pjesë e këtij udhëzimi, bëhet pjesë e praktikës doganore dhe përmban të dhëna të përgjithshme të mostrës së analizuar dhe klasifikuar (kërkuesin, mallin, kodin tarifor, etj.), si dhe

konkludimin në lidhje me klasifikimin tarifor dhe emërtimin e mallit. Kjo çertifikatë është e vlefshme në origjinal dhe vetëm për mostrën e analizuar dhe klasifikuar. Ajo firmoset vetëm në kopjen që arshivohet në DPD nga specialisti dhe Përgjegjësi i Sektorit të Tarifës dhe Klasifikimit Tarifor. Kjo Certifikatë shoqërohet me Raportin e Testimit dhe shkresën përcjellëse të nënshkruar nga eprorët.

**9.2**"*Çertifikata verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor*" përgatitet në 3 (tre) kopje origjinale të cilat shpërndahen si më poshtë:
- një kopje e çertifikatës e firmosur nga specialisti dhe Përgjegjësi i Sektorit të Tarifës dhe Klasifikimit Tarifor, së bashku me Raportin e Testimit dhe praktikën arshivohet në arshivën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. si dhe
-dy kopje pa firmat e specialistit dhe të Përgjegjësit të Sektorit të Tarifës Klasifikimit Tarifor tërhiqen në Zyrën e Protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nga personi i autorizuar nga Dega Doganore.

Njërën kopje të "*Çertifikatës së Verifikimit të Llojit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor*", Degët Doganore kanë detyrimin t'ia bashkëngjisin praktikës doganore.

Çertifikatën tjetër origjinale me konkludimin e nxjerrë nga DTO, menjëherë pas tërheqjes nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Degët Doganore duhet t'ia dorëzojnë menjëherë subjektit ose përfaqësuesit të tij ligjor.

Në rastet kur kërkesa për klasifikim tarifor të mostrës është bërë nga një apo disa Drejtori të tjera brenda strukturës doganore hartohen nga një kopje e "*Çertifikatës së Verifikimit të Llojit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor*" për secilën nga këto Drejtori përveç kopjeve të përmendura në paragrafin e mësipërm.

Në rast se kërkesa për klasifikim tarifor është bërë nga organe të tjera jashtë strukturës doganore, hartohen 3 kopje origjinale të çertifikatës, një kopje arkivohet në arshivën e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, një kopje i kthehet DTO, një kopje i dërgohet kërkuesit.

**9.3** "*Fletë analiza*" sipas formatit të Aneksit 9, bashkëlidhur, pjesë e këtij udhëzimi, bëhet pjesë e praktikës doganore dhe përmban të dhëna të përgjithshme të mostrës së analizuar (kërkuesin, mallin, kodin tarifor, etj.), shënimin përkatës mbi pamundësinë e klasifikimit 8 shifror të mallit si dhe opinionin dhe interpretimin mbi mostrën.. Ky dokument është i vlefshëm në origjinal dhe vetëm për mostrën e analizuar. Ai firmoset nga specialisti dhe Përgjegjësi i Sektorit të Tarifës dhe Klasifikimit Tarifor vetëm në kopjen që arshivohet në DPD dhe shoqërohet me Raportin e Testimit si dhe shkresën përcjellëse të nënshkruar nga eprorët.

Shpërndarja e tij bëhet duke ndjekur të njëjtën skemë si me "Çertifikatën e verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor" në varësi të strukturave që e kanë kërkuar.

**9.4** Nëpërmjet sistemit LIMS, pas hartimit të "Certifikatës së Verifikimit të Llojit të Mallit dhe Klasifikimit Tarifor" apo "Fletë analizës" Dega Doganore që ka kërkuar klasifikimin tarifor të mostrës, njihet menjëherë me konkluzionin e saj.

**9.5** Nëse pas klasifikimit tarifor të dhënë nga DTO, konstatohet që kemi të bëjmë me ndryshim të kodit tarifor, , Dega Doganore së bashku me çertifikatën origjinale i dërgon subjektit/përfaqësuesit të tij edhe proçes-verbalin e mbajtur për shkeljen, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, VKM nr.651, date 10.11.2017 "Per Dispozitat Zbatuese të Ligjit nr.102, date 31.07.2014 "Kodi Doganor I RSH", I ndryshuar, Ligjit 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, "VKM 612, dt.

05.09.2012, "Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**9.6** Dega Doganore në cdo rast te marrjes së vendimit për Certifikatat me klasifikimin tarifor të ndryshëm nga ai i deklaruar , njofton Drejtorinë e Tarifës dhe Origjinës për këto vendime në rrugë shkresore si dhe nëpërmjet sistemit LIMS.

## 10.KONTESTIMI I REZULTATIT TË ANALIZËS DHE TË KLASIFIKIMIT TARIFOR

**10.1** Kontestimet e rezultateve të analizave në çdo rast depozitohen pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe trajtohen sipas përcaktimeve në Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, VKM nr.651, date 10.11.2017 "Per Dispozitat Zbatuese të Ligjit nr.102, date 31.07.2014 "Kodi Doganor I RSH", I ndryshuar, Ligjit 61/2012 "Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, "VKM 612, dt. 05.09.2012, "Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

**10. 2** Ankesa e protokolluar në DPD përcillet për trajtim në Drejtorinë e Tarifave dhe Origjinës nga Shefi i Departamentit Teknik. Kjo drejtori vlerëson të gjitha hallkat e procesit klasifikimit tarifor. Në se hasen pasaktësi në Klasifikimit Tarifor të dhënë nga DTO, atëherë kjo drejtori informon Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave mbi ecurinë e këtij kontestimi dhe propozon për riklasifikim tarifor.
Në rastet kur kemi të bëjmë me kontestimin e rezultatit të analizave, Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës bashkëpunon me Drejtorinë e Laboratorit. Drejtoria e Laboratorit përgatit një relacion shpjegues me argumenta të detajuara për të gjitha hallkat, që nga momenti i pranimit të mostrës dhe kryerjes së analizave kimike, duke argumentuar rezultatin e dhënë. Argumentimet e detajuara i dërgohen Drejtorit të Drejtorisë së Tarifës për ndjekje të mëtejshme

Për rastet, kur konstatohen pasaktësi në analizat e kryera në laborator,atëherë, DLD informon Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave dhe DTO mbi këto pasaktësi dhe propozon për rianalizimin dhe riklasifikim tarifor të mostrës.

**10. 3** Në rast se ankesa pranohet, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave urdhëron analizimin dhe klasifikimin e mallit nëpërmjet mostrës dublikatë, Përfundimet e nxjerra nga DTO për klasifikmin tarifor të mostrës dublikatë i dërgohen Degës Doganore përkatëse ose strukturave të tjera, që kanë kërkuar marrjen e mostrës si dhesubjektit ankues.

**10.4** Në rast se ankesa nuk pranohet, DTO vë në dijeni Dega Doganore dhe subjektin.

**10.5** Në rast se Dega Doganore ka dalë me vendim dhe nuk janë kontestuar rezultatet e analizimit nga subjekti para marrjes së këtij vendimi, atëherë ndiqet proçedura e përcaktuar në Kodin Doganor ose në Ligjin "Për Akcizat".

## 11. AFATET E RUAJTJES SË MOSTRAVE NË DEGËT DOGANORE

